AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Prill 2024

10.05.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Prill 2024, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 2,4% vjetore dhe 0,1% mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,4% në muajin prill 2024, krahasuar me muajin prill 2023. Inflacioni mujor ishte 0,1% në muajin prill 2024.

Prill 2024 / Prill 2023 2,4 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,4 % në muajin Prill 2024 krahasuar me muajin Prill 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pushime të organizuara (14,5%), pemët (12,5%), pijet alkoolike (9,2%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (8,7%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (8,2%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (7,0%), kafja, çaji dhe kakao (6,2%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (6,0%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (5,6%), veshje (4,6%), shërbimet për transport (4,3%), gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (4,3%), kujdesi personal (4,0%), buka dhe drithërat (3,1%), perimet (2,9%), duhani (2,9%), energjia elektrike (2,2%), shërbimet hoteliere (2,1%), mishi (1,4%), blerja e automjeteve (1,3%) dhe karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (0,9%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,7 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: qumështi, djathi dhe vezët (-4,2%) me një ndikim prej -0,3 për qind në IHÇK-it.

Prill 2024 / Mars 2024 0,1 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,1% në muajin Prill 2024 krahasuar me muajin Mars 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (15,8%), pemët (3,3%), kafja, çaji dhe kakao (1,2%) dhe uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (0,5%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,3 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it energjia elektrike (-8,9%) me një ndikim prej -0,2 për qind në IHÇK-it.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2024 në ‰	IV - 2024 2015=100	IV- 2024 III- 2024	IV - 2024 IV - 2023
00	Gjithsej IHÇK	1000,0	130,1	0,1	2,4
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	351,1	145,3	0,4	2,2
02	Pijet alkoolike, duhani	67,6	139,7	0,1	4,8
03	Veshje dhe këpucë	40,6	108,5	-0,1	2,9
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89,8	121,5	-3,3	4,1
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	63,0	122,1	0,1	3,4
06	Shëndetësia	22,8	116,2	0,1	2,0
07	Transporti	176,7	122,4	1,2	1,1
08	Mjetet e komunikimit	23,7	114,5	0,0	-0,2
09	Rekracioni dhe kultura	44,5	106,4	0,0	4,2
10	Arsimi	6,9	104,0	0,0	-0,9
11	Restorantet dhe hotelet	40,8	129,5	0,0	2,1
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	72,2	119,2	0,1	2,1

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin prill 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS